



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Prishtinë, 15.05.2019

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L – 149 neni 12 pika 4 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, shpall:

KONKURS
për
Marrëveshje me Shërbime të Veçanta

Titulli i punës : Zyrtar për Trashëgimi Kulturore

Koeficienti: 7

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Kohëzgjatja e emërimit: 6 (gjashtë) muaj

Orët e punës: 40 orë në javë

Raporton: Udhëheqësi i Divizionit / Programit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale

Vendi i punës: Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Pranon aplikacionet e propozuara mbi shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme;
2. Analizon dhe shqyrton në përputhje me procedurat e përcaktuara, parimet, kriteret dhe rregullat në fuqi;
3. Përgatit raportin me rekomandime për shpallje ose refuzim të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme;
4. Identifikon pengesat dhe problemet, analizon, dhe raporton për gjendjen e trashëgimisë kulturore, duke propozuar masat shetesë për ruajtje dhe mbrojtje.
5. Në bashkëpunim me udhëheqësin koordinon përgatitjen e programit për vetëdijesim publik, për nxitjen e arsimit, ngritjen e vetëdijes, partneritetit dhe bashkëpunimit në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
6. Ofron këshilla në fushën e ekspertizës së kërkuar brenda institucionit;
7. Përgatit raporte periodike mbi aktivitetet organizative dhe çështjeve që kërkojnë shqyrtim nga Udhëheqësi i Divizionit / Programit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Shkathtësit e kërkuara:

- Diplomë universitare në: konservim dhe restaurim, arkitektur, trashëgimi kulturore
- Njohuri në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me trashëgimi kulturore;

- Shkathësi në komunikim planifikim të punës ;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit)

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kompleksi Rilindja, kontejneri nr.3 kati i II (dytë) zyra nr.206, Prishtinë, Kosovë ose në form elektronike: <http://kktk.rks-gov.net> Për informata të hollësishme mund të kontaktoni Tel: +381 (0) 38 211 617, prej orës 08:00-16:00. Konkursi është i hapur nga data 15.05.2019 deri me datë 22.05.2019.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen .Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontakohen.